

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo			
Nr. i prot. Br.prot./Prot.Nr.	1013/ZDP/315		
Faqe: Stranica/Pages	2	Kopje: Kopija/Copy	-
Datum/Date		12.09.2023	
Hyrës/ulazno/in.....	<input type="checkbox"/>		
Dalës/izlazno/out.....	<input checked="" type="checkbox"/>		
Brendshëm/interno/internal.....	<input type="checkbox"/>		
Prishtinë/Prishtina/Pristina			

07/ZDP/VE/2023  
Datë: 12 shtator 2023

Në mbështetje të nenit 15.1 (d) dhe (j), 37 dhe 39.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt. 1 mars 2019), në pajtim me Shtojcën II, Nën-pjesën D, pikën ATCO.AR.D.005 (e) të Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror,

Duke marrë për bazë rekomandimin e Departamentit të Shërbimit të Navigacionit Ajror lidhur me revokimin e gradimeve/miratimeve, së dt. 07 shtator 2023 me nr. prot. 2023/SHNA/311,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

## V E N D I M

- REVOKOHEN** gradimet/miratimet APS/APP të Kontrollorit të Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajror, me numër të licencave CAA015 me dt. të parë të lëshimit 18.03.2004.
- OBLIGOHET** Departamenti i Shërbimeve të Navigacionit Ajror në përputhje me legjislationin në fuqi të marrë të gjitha masat e nevojshme lidhur me zbatim të këtij Vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi më ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Më dt. 07 shtator 2023, Departamenti i Shërbimit të Navigacionit Ajror përbrenda AAC-së, ka prapuar kërkesën nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, për revokim vullnetar të gradimeve/ miratimeve APS/APP të kontrollorit të trafikut ajror me numër të licencës CAA015. Kërkesa fillestare për revokim ishte bërë nga vetë kontrollori I trafikuar ajror më dt. 28 gusht 2023.

Pas pranimit të kërkesës nga ASHNA dhe analizës së rastit, Departamenti i ShNA-së ka bërë rekomandimin për Drejtorin e Përgjithshëm, përmes së cilit ka ardhur në përfundim që Kontrollori në fjalë ka kërkuar me vet dëshirë të largohet nga përgjegjësitë e gradimeve/miratimeve APS/APP. Në bazë të rekomandimit kontrollori me nr. të licencës CAA015 mund t'i ushtroj vetëm privilegjet në njësinë BKPR, Sektorin TWR, gradimet ADV/ADI si dhe miratimet TWR/GMC/AIR.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenet 15.1 (d) dhe (j), 37 dhe 39.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave Hlogaridhënëse të agjencive të pavarura, me Shtojcën II, pikën ATCO.AR.D.005 (e) të Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, dhe rekomandimit të departamentit SHNA ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ngrit kontest administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimiit.



Iu dërgohet:

- Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Vrellë, Komuna e Lipjanit;
- Departamenti i Shërbimeve të Navigimit Ajror; dhe
- Arkivit të AAC-së.